ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΟ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ
ΑΡΧΕΙΟ ΕΥΛΟΓΙΟΥ ΚΟΥΡΙΛΑ
Αρ. Εγγρ.: 1/1481

Tiranë, 9 Qershor 1939

Fort i ndershem Im-Ungj.

Nga miqt qe kane ardhur ketu kam mesuar shendetin t'uaj dhe kam marre te fala e jam gezuar.

Mesova edhe se per ne Greqi vendoste te dergoni Dhiakun e te mos vini vete. Ky mejtim me pelqeu dhe, bilé, kam dashur t'ju shkruanj per kete, se nuk esht koha te largohi, ndonse mund te kini nevoje shendetesore po e lini mê von.. ἀνάγκᾳ καὶ Θεοὶ πείθονται.

E pashe par edhe mikun Nafi, e filloi, si pas zakonit, verrejtje e kritika, po nga te tjeret kam degjuar mire. U-poqa edhe me z. Vangjel Turtulin, senator (!).

Me rastin qe do vete Dhiakuo tashi, besoj se do te kujtohi t'a porositni te na e sjelle Engjiklopedine qe me zotuate.

Kosta yne me shkruante qe vendosi te vinje kete muaj me te rregulluar disa formalitete.

Tere familja ime ju puth doren dhe ju uron shendet.

Ketu mbyllur vé nje kart-vizite per mikun z. Kondi. Te fala Dhiakos.

Me nderim

Vasili

ΠΑΝΕΠΙΣΤΗΜΙΑΚΗ ΒΙΒΛΙΟΘΗΚΗ ΙΩΑΝΝΙΝΩΝ